

**STATUTI**

**I**

**SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR**

**``Euro Edil``**

**SH.P.K**

## Përmbledhje

<b>KREU 1</b>	<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b>	
<b>KREU 2</b>	<b>EMRI , SELIA KOHËZGJATJA</b>	<b>NENET 1-4</b>
<b>KREU 3</b>	<b>KAPITALI NDRYSHIMI DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT DHE KUOTAVE</b>	<b>NENET 5-8</b>
<b>KREU 4</b>	<b>ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTËT KONTABËL</b>	<b>NENET 9-13</b>
<b>KREU 5</b>	<b>VITI FINANCIAR,BILANCI VJETOR , SHPËRNDARJA E FITIMEVE</b>	<b>NENET 14-15</b>
<b>KREU 6</b>	<b>SHPËRNDARJA TRANSFORMIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË</b>	<b>NENET 16-18</b>
<b>KREU 7</b>	<b>ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE</b>	<b>NENI 19</b>



# S T A T U T I

## I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

### **“Euro Edil” shpk**

#### **KREU 1**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Euro Edil” shpk** (më poshtë Shoqëria) është themeluar sipas Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti, mbështetur në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare’ dhe Ligjin Nr. 131/2015 dateë 3.5.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithësi, të përpiluara dhe nënshkruar nga Ortakët:

1. **Z. Dorjan Bulku**, i biri i Ibrahim, lindur në Peshkopi, më 25.09.1982, banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 034970128, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Z. Ilir Khani**, i biri i Xhemali, lindur në Durrës, me 27.07.1969, banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 031186030, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Z. Muharrem Khani**, i biri i Xhemali, lindur në Durrës, me 02.11.1980, banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 028994851, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### **KREU 2**

#### **EMRI, SELIA , OBJEKTI , KOHËZGJATJA**

##### **NENI 1 : EMRI I SHOQËRISË**

- 1.01 Emërtimi i shoqërisë së krijuar është **“Euro Edil” shpk** , ndërsa
- 1.02 Emri tregëtar (titulli dallues ) është **Euro Edil**.
- 1.03 Emri si më sipër , i përkthyer në gjuhën angleze , do të përdoret në marrëdhëniet e shoqërisë në raportet e biznesit me subjektet dhe vendet e huaja.
- 1.04 Shoqëria është krijuar me mjetet në pronësi të themeluesve të saj. Ajo rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.
- 1.05 Shoqëria është person juridik shqiptar dhe e fiton këtë të drejtë që nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.06 Shoqëria ka vulën e saj në të cilën shkruhet: **SHOQËRIA TREGETARE Euro Edil shpk**



## **NENI 2 : SELIA E SHOQËRISË**

2.0 Shoqëria ka Selinë e saj qendrore në: RRASHBULL SHENAVLASH Vrrine, Zona Kadastrale 3339, Tokë arë me nr. pasurie 4/48, pranë rrugës së fshatit Rinia, Durrës.

2.01 Shoqëria me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të hapë pika shërbimi, agjensi , filiale , zyra përfaqësimi apo degë në qytete të tjera brënda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit .

2.02 Degët , agjensitë, filialet , pika shërbimit apo zyrat e përfaqësimit mund të formohen sipas kushteve të veçanta të krijimit dhe funksionimit të tyre, të përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve, duke plotësuar dokumentacionin ligjor dhe formal, sipas kërkesave të përcaktuara edhe nga organet kompetente në R.Sh apo jashtë saj.

## **NENI 3: OBJEKTI**

3.0 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën:

Tregti të materialeve të ndërtimit dhe hidroizolimit me shumicë e pakicë , import eksport. Punime hidroizolimi, aplikim i materialeve të veta në objekte për llogari të të tretëve.

3.01 Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

## **NENI 4: KOHËZGJATJA**

4.0 Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj me **afat të pakufizuar**. Ky afat mund të shkurtohet apo ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

4.01 Afati i ushtrimit të aktiviteti për Shoqërinë **“Euro Edil” shpk** fillon nga momenti regjistrimit sipas kërkesave ligjore në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## **KREU 3**

### **KAPITALI THEMELTAR, NDRYSHIMI DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT DHE KUOTAVE**

## **NENI 5: KAPITALI THEMELTAR**

5.0 Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, vihet një kapital bazë që përbën burimin fillestar për krijimin e fondit themelor dhe të mjeteve të xhiros.

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është në shumën 12,500,000 (dymbëdhjetë milion e pesëqind mijë ) Lekë. Ai është nënshkruar dhe i paguar plotësisht prej ortakëve të shoqërisë . Ky kapital është ndarë në 3 (tre) kuota

Kuotat janë të ndara në këtë mënyrë:

- 1. Z. Dorjan Bulku 1 Kuotë me vlerë 4,125,000 Lekë 33% e kapitalit themeltar**
- 2. Z. Ilir Xhani 1 Kuotë me vlerë 4,250,000 Lekë 34 % e kapitalit themeltar**
- 3. Z. Muharrem Xhani 1 Kuotë me vlerë 4,125,000 Lekë 33 % e kapitalit themeltar**

5.01 Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie, në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 6: RRRITJA E KAPITALIT**

6.0 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi, në çdo moment, një apo disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve, që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar

6.01 Në rast rritje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me kuotën dhe pjesën në përqindje të kapitalit të zotëruar.

6.02 Në rast se një apo më shumë ortakë nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive.

#### **NENI 7 : ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

7.0 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, me votën pro të ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.

7.01 Në çfarëdo rasti kapitali themeltar I shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga Ligji.

7.02 Zvogëlimi i kapitalit prek secilin prej ortakëve në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që zotërojnë.

7.03 Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me fondet e veta.

#### **NENI 8: TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT DHE E DREJTA E PARABLERJES**

8.0 Kuotat dhe pjesët e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve pjesërisht ose tërësisht, vetëm me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.

8.01 Transferimi në çfarëdo lloj forme i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë, të cilët mund të



ushtrojnë këtë të drejtë në raport me pjesët e tyre të kapitalit, brënda 15 Ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me Lajmërim marrje. Ky njoftim përmban;

- a) ofertën që parashikon çmimin e shitjes,
- b) kushtet,
- c) kushtet dhe modalitetet,
- d) të dhënat për identifikimin e blerësit,
- e) afatet e transferimit.

Në rast se ortakët nuk përgjigjen brënda afatit të parashikuar më sipër, prezumohet se kanë hequr dorë prej të drejtës së parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit të ofruar për shitje.

8.02 Në rast se për ofertën tregojnë interes disa ortakë njëherësh, pjesët e kapitalit të ofruar nga ortaku që kërkon të transferojë pjesët e kapitalit, do të ndahen ndërmjet ortakëve pranues në të njëjtin raport me pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje me shkrim të ndryshme sa parashikohet këtu më sipër.

8.03 Nëse njëri prej ortakëve refuzon apo heq dorë nga ushtrimi i të drejtës së tij të parablerjes, ortakët e tjerë, të cilët tashmë e kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes, mund ta ripërdorin këtë të drejtë edhe për pjesën e ofruar ortakut që refuzoi ofertën.

8.04 Ortakët që dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e tyre të parablerjes, për këtë qëllim, duhet ti njoftojnë ortakut që kërkon të transferojë pjesët e tij të kapitalit brënda 15 Ditësh që prej marrjes së lajmit për mos ushtrimin e të drejtës së parablerjes prej ndonjërit prej ortakëve.

8.05 Në rast se vetëm njëri prej ortakëve dëshiron të ushtrijë të drejtën e parablerjes, pjesa e kapitalit të ofruar I transferohet atij tërësisht ose në atë masë që ky ortak dëshiron të blejë.

8.06 Të gjitha njoftimet e sipërpërmendura do të bëhen me shkrim dhe do i adresohen Administratorit të Shoqërisë.

#### **KREU 4**

### **ASAMBLEJA ORTAKËVE, ADMINISTRATORI/ËT DHE EKSPERTI KONTABËL**


#### **NENI 9: ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE KOMPETENCA T E SAJ**

9.0 Organi më i lartë vendimmarës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve (më poshtë Asambleja)

9.01 Vendimet e miratuara me shumicë votash nga Asambleja janë të detyrueshme për ortakët që nuk janë të pranishëm ose që nuk janë dakort, përveç së drejtës së tyre të kundërshtimit, që ushrohet në rastet, afatet dhe formën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

9.02 Kompetencat kryesore të Asamblesë si organi më i lartë vendim marrës, por pa u kufizuar vetëm në to, janë si më poshtë:

- Përcaktimi i të drejtave kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.
- Ndryshimet në objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Propozimet e nevojshme për ndryshimet në kapitalin bazë të shoqërisë.





- Përcaktimi i rregullave dhe i normave, që përkufizojnë raportet brenda shoqërisë, duke përfshirë edhe kuadrin e personelit.
- Përcaktimi i strukturës së aparatit organizativ të shoqërisë.
- Përcaktimi i organikeës dhe ndarja e vendeve drejtuese si dhe pozicioneve të tjera në organizimin e shoqërisë.
- Emërimi dhe zëvendësimi i Administratorëve të përgjithshëm të shoqërisë.
- Krijimi i organeve të tjera të domodoshëm për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Përcaktimi i madhësisë së kuotave për formimin e kapitalit bazë të shoqërisë.
- Paraqitja e propozimeve për rregullimin, krijimin dhe përfitimin nga fondet e veçanta, ndarjen e fitimeve dhe përcaktimi i rregullave për shlyerjen e borxheve.
- Marrja e vendimit për krijimin e filialeve të degëve e të përfaqësive si dhe për çedimin veprimtarisë së tyre.
- Përcaktimi i rregulloreve për procedurën e punës të administratës.
- Peërgatitja e propozimit për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Përzgjedhja e antarëve për komisionin e likuidimit të cilët emërohen dhe revokohen prej tij.
- Marrjen e vendimit për marje huaje, kredi, venie si garanci hipotekore apo barrësime të tjera ligjore të aseteve apo të drejtave të tjera në pronësi të shoqërisë.

9.03 Asambleja verifikon dhe kujdeset që ortakët të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotat suplementare në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin.

9.04 Asambleja garanton të drejtën e ortakëve për të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara, të kryejnë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.

## **NENI 10: E DREJTA E PJESËMARRJES DHE E VOTËS**

10.0 Çdo ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamble ku të paraqesë mendimin dhe propozimet tij, si dhe të votojë me aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që ai zotëron.

10.01 Ortakët kanë të drejtën të përfaqësohen vetë apo nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim sipas përcaktimeve ligjore, me anën e të cilit mund të ushtrojë të drejtën e votimit të tij.

10.02 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

## **NENI 11: THIRRJA E ASAMBLESE**

11.0 Asambleja thirret në Mbledhje të Zakonshme dhe Jashtëzakonshme, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij.

11.01 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga Administratori apo njëri prej tyre kur janë më shumë se një, ekspertët kontabël (nëse është i emëruar një i tillë),



likuidatori/ët (nëse është emëruar), si dhe prej njërit ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.

11.02 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me Letër të porositur, që mund t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton e deklaruar dhe regjistruar në Librin e Ortakëve dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë. Thirrja e dërguar duhet të përmbajë minimalisht informacionin për: 1) Lloji i mbledhjes (e Zakonshme apo Jashtëzakonshme); 2) Rendi i çështjeve që do të diskutohen dhe votohen; 3) Vendi ku do të mbahet mbledhja; 4) Orën dhe datën e thirjes.

11.03 Mbledhja e Asamblesë mund të mbahet edhe nëpërmjet telekonferencës /video konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe t'i lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve, pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

11.04 Asambleja do të thirret dhe konsiderohet e mbajtur rregullisht edhe pa respektuar formalitetet e njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.

11.05 Vendimet e Asamblesë duhet të pasqyrohen në proces verbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari I Asamblesë dhe nga Sekretari, i cili mban procesverbalin gjatë zhvillimit të mbledhjes. Në proces verbal mund të paraqiten përmbledhurazi, me kërkesë të ortakëve, edhe pretendimet apo deklaratat e tyre të veçanta, të paraqitura gjatë mbledhjes.

11.06 Asambleja thirret në Mbledhje të Zakonshme jo më pak se një herë në vit, brënda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit për miratimin e llogarive të Shoqërisë, të raportit të administrimit të hartuar nga Administratori, të raportit të ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.

11.07 Mbledhja e zakonshme e Asamblesë konsiderohet e rregullt dhe mund të marrë vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë) të kapitalit të shoqërisë.

11.08 Asambleja në mbledhjet e zakonshme vendos mbi të gjitha çështjet që nuk vendosen në mbledhjet e jashtëzakonshme dhe në veçanti, por pa kufizuar, për sa vijon:

- Emërimin apo zëvendësimin e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar)
- Miratimin e strategjive të zhvillimit, organizimit dhe administrimit të Shoqërisë, zhvillimit të aktivitetit tregëtar, politikat e çmimeve dhe shitjeve, buxhetit, llogarive vjetore, të raporteve të Administratorit dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe inventarit
- Shpërndarjen e fitimeve që mund të rezultojnë
- Krijimin e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë brënda apo jashtë vendit



11.09 Mbledhja e jashtëzakonshme e Asamblesë konsiderohet e rregullt dhe mund të marrë vendime të vlefshme në mbledhjen e pare dhe të dytë, me votimin e ortakëve që përfaqësojnë të paktën ¼ e kapitalit të Shoqërisë.

11.10 Asambleja mund të marrë vendime në mbledhje të jashtëzakonshme veçanërisht, por pa u kufizuar për sa vijon:

- Ndryshimin e Statutit të shoqërisë, pjesërisht apo tërësisht
- Rritjen apo zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë
- Ndryshimet në objektin e veprimtarisë
- Blerjen e pjesëve të kapitlalet në shoqëri të tjera
- Transferimin e pjesëve të kapitalit të shoqërisë te të tretët
- Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ve

## **NENI 12: ADMINISTRIMI**

12.0 Veprimtaria operative e shoqërisë, e cila përfshin të gjithë kopetencat e administrimit të zakonshëm dhe jashtëzakonshëm të shoqërisë, brenda kufijve të objektit të veprimtarisë, me përjashtim të atyre që ligji ose Statuti ia atribuon Asamblesë, drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në shoqërinë **“Euro Edil” shpk** Administrator i shoqërisë do të jetë:

**Z. Dorjan Bulku**, i biri i Ibrahim, lindur në Peshkopi, më 25.09.1982, banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 034970128, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

12.01 Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh financiarë.

12.02 Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh.

12.03 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm, për veprime apo kategori të caktuara veprimesh

12.04 Administratori/ët ka këto kompetenca kryesore:

- Organizojnë punën për realizimin e planeve e objektivave të shoqërisë dhe raportojnë për to në përputhje me programet e planet e përgjithshme si dhe administron pasurinë e shoqërisë, brenda kompetencave të caktuara nga ky statut si dhe ligji në fuqi.
- Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e filialeve të degëve e të përfaqësive.
- Raporton dhe i përgjigjet Ortakëve për zbatimin e veprimtarive të shoqërisë si dhe për realizimin e objektivave dhe detyrave që janë në kompetencë të tij me bazë 1 mujore, nëpërmjet shkresave zyrtare apo postës elektronike të regjistruar në librin e ortakëve, apo edhe të deklaruar prej vetë tyre ,si adresë për komunikime të tilla.
- Siguron drejtimin e rregullt të shoqërisë konform legjislacionit shqiptar në fuqi, apo çdo akti tjetër ligjor të cilit do t'i nënshtrohet veprimtaria e shoqërisë.



- Përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët brenda caqeve të objektit të veprimtarisë së saj, përveç çështjeve që kërkojnë domosdoshmërisht vendimin e Asamblesë së Ortakëve ose që kanë të bëjnë me kompetencat që ky statut i atribuon Asamblesë së Ortakëve.
- Organizon dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e saktë të vendimeve të Asamblesë së Ortakëve.

#### 12.04.01 KUFIZIME KOMPETENCASH TË ADMINISTRATORIT

- Administratori në çdo rast për emërimin e konsulentëve financiar, ligjor, avokatëve etj të cilët do të përfaqësojnë shoqërinë në çështje gjyqësore apo çështje në të cilat nevojitet ekspertizë në fusha të veçanta, duhet të marrin aprovimin e Asamblesë
- Administratori përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie kreditimi apo huamarrje , nëse Asambeja nuk ka marrë një vendim të kundërt .
- Administratori kryen veprimet financiare me të tretë dhe në të gjitha bankat e nivelit të dytë.

12.05 Marrdhëniet e punës në shoqëri e filiale, në degë e përfaqesitë rregullohen në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë, legjislacionit shqiptar dhe me këtë statut si dhe nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk rregullohen në kontratën e punës, zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës. Punësimi i punonjësve në shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës kolektive dhe individuale të punës.

Mbi këtë bazë Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarve pranë saj në organet përkatëse duke derdhur rregullisht kontributet në përqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.

12.06 Administratori shpërblehet me page mujore, në masën e cila përcaktohet me vendim të Asamblesë.

### **NENI 13: EKSPERTI KONTABË I AUTORIZUAR**

13.0 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.

13.01 Eksperti kontabël i autorizuar emërohet nga Asambleje për një periudhë 1 (një) vjeçare.

13.02 Eksperti kontabël mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi

## **KREU 5**

### **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **NENI 14: VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR**

14.0 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.



14.01 Viti I parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

14.02 Llogaritë vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e ortakëve të cilët zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar.

14.03 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brënda 6 (gjasthë) muajve nga fundi i vitit përkatës financiar.

14.04 Llogaritë vjetore duhet të vërtetohen në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit

#### **NENI 15: FITIMET**

15.0 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur të gjitha shumatat që Asambleja vendos ti kalojë për rezerva të tjera, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruar.

15.01 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shlyerjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, në vitet e ardhshme financiare.

15.02 E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbritet amortizimi i të gjithë pasurisë së luajtëshme e të palujtëshme, sipas afateve të caktuara, kuotat që kanë të bëjnë me kreditë për investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet për lëndët e para apo ndihmëse e energjinë si dhe shpenzimet e përgjithshme të saksioneve të shoqërisë dhe ato për qëllime të tjera prodhuese e joprodhuese, i takojnë ortakëve themelues të saj.

### **KREU 6**

#### **SHPËRNDARJA, TRANSFORMIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 16: SHPËRNDARJA E SHOQËRISË**

16.0 Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin të ortakëve, kur gjatë dy vjeteve nuk rezulton rentabël ose kur ortaku heq dorë nga Shoqëria si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë. Shoqëria shpërndahet në forme riorganizimi ose likuidimi

16.01 Shoqëria mund të shpërndahet përpara afatit të caktuar nga Statuti, në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

16.02 Shoqëria nuk shpërndahet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

##### **NENI 17: LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

17.0 Në rast se plotësohen kushtet ligjore për prishjen e Shoqërisë, atëherë ajo duhet likuidohet.



17.01 Për të drejtuar procedurën e likuidimit të Shoqërisë, Asambleja e ortakëve do të emërojë një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar si proces.

17.02 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e ortakëve do të vendosë mbi llogaritë financiare përfundimtare, mbi vlefshmërinë e punës së kryer nga likuidatorët dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

17.03 Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin e shoqërisë

### **NENI 18: TRANSFORMIMI I SHOQËRISË**

18.0 Kjo Shoqëri mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo në shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës Ligjore

18.01 Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri kolektive vetëm me miratimin unanimit të ortakëve.

18.02 Shoqëria mund të transformohet në Shoqëri Aksionare me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.

18.03 Shoqëria mund të riorganizohet vetëm pasi ka qenë e regjistruar për të paktën 1 vit.

18.04 Bashkimi i Shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.

## **KREU 7**


### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

#### **NENI 19: ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

19.0 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe /ose zbatimin e këtij statuti dhe akti themelimi, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale jashtë veprimtarisë së Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

19.01 Në rast se mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen si më sipër, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Date 06/05/2020





**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**“Euro Edil” shpk**

**Dorjan Bulku**

Dorjan Bulku

**Iir Xhani**

Iir Xhani

**Muharrem Xhani**

Muharrem Xhani